

FJALA E DEPUTETIT SALI BERISHA

E HËNË 23 MAJ 2022

Zotërinj deputetë,

Zonja deputete,

Zonja drejtuese e seancës,

Të dashur qytetarë dhe qytetare,

Sot këtu debatohet për një institucion, i cili, me të gjithë potencialin e tij, dëshmoi se është i gatshëm të funksionojë si institucion i censurës. Si asnjëherë në ekzistencën e këtij institucioni, Edi Rama dhe mjerisht peng-Basha emëruan kryetare dhe zëvendëskryetar njerëzit më të besuar të tyre, në vend që ai institucion të drejtohej nga përfaqësues relativisht të pavarur ose gjysmë të pavarur të medieeve. Është e kotë të diskutosh se kurrë ndonjëherë nuk ka pasur këtë shkallë ekstreme politizimi, me gjithë kërkesën, insistimet e medieeve dhe të institucioneve ndërkombëtare që ky institucion të jetë i balancuar, të jetë më i pavarur, më i paanshëm. Ndaj, nuk ia vlen t'i kushtosh as edhe një minutë më shumë institucionit të AMA-së, por do të ndalem te gjendja dramatike që ekziston në medie dhe te fjala e lirë në Shqipëri.

Narkoshteti apo autokracia e narkoshtetit në vetvete është shteti shtypës i lirive, i të drejtave të individit në seri, por edhe fjalës së lirë dhe lirisë së medieeve, në veçanti. Janë të zakonshme aktet bandite të qeveritarëve ndaj gazetarëve dhe ndaj medieeve të lira; janë të zakonshme sulmet agresive staliniste të qeveritarëve ndaj medieeve që shkruajnë kundër tyre. Në rast se bëjmë një shumim, dy janë armiqtë kryesorë të fjalës së lirë në Shqipëri: njëri quhet Edi Rama, i cili, përveç sjelljes së dhunshme verbale, përveç fyerjeve, ndëshkimeve absurde ndaj gazetarëve për shkak të pyetjeve që i bëjnë, krijoi edhe agjencinë e dezinformimit, i frymëzuar nga regjimet autokratike, ministrinë e së vërtetës, përgatiti ligjet për të dënuar të gjitha portalet, që nuk i nënshtrohen atij, ndërmoi sanksione, duke ushtruar presion mbi pronarët e medieeve në rast se linjat e tyre editoriale nuk përputhen plotësisht me të qeverisë.

Edi Rama i lejon vetes të përdorë fyerje, sharje dhe kërcënime ndaj gazetarëve, për të cilat do ta kishin lakmi edhe etërit e tij, ish-xhelatë të fjalës së lirë. Ai është bërë i famshëm edhe në Europë për fjalorin e tij, për ndëshkimet që u bënë gazetarëve për pyetjet që nuk i pëlqejnë, deri te reminishencat e fëmijërisë së tij, kur gjyshja i thoshte: “Mos u zgërdhi si budalla” e, ndërkohë, ai i thoshte gazetarit: “Gjyshja ime

më ka thënë se nga buzët e budallait, dalin vetëm buzëqeshje”. Në fakt, është atribut personal i gjyshes së tij, që një njeri me një kulturë mizerabël, ta themi atë që është, të gjithë pasurinë e tij e bazon te filmat e Kinostudios “Shqipëria e re” dhe te librin e mashtrimeve të Nastradinit. Po kaq armik i fjalës së lirë është edhe Erion Veliaj.

Ai përbën variantin më të shëmtuar të zyrtarit, të qëndrimit ndaj fjalës së lirë, ndaj gazetarëve dhe ndaj pronarëve të medieve. Imagjinojeni, të dy vijnë nga “Shoqëria e hapur” e Xhorxh Sorosit! Ata janë fabrikantë e “Shoqërisë së hapur”, e cila për definicion duhet të jetë e kundërta. Pra, kemi të bëjmë me një situatë dramatike, për të cilën edhe AMA ka shkallën e saj të përgjegjësisë. A i keni vënë re këto ministre, jo dhe aq të nderuara, të cilat i nxjerr si gazetarë para medieve për të mos i lejuar gazetarët të flasin atë që duan të thonë?! A ndodh kjo në ndonjë vend? Ndodh vetëm në Kanabistan. A e keni konstatuar që nuk i lejon ministret dhe ministrat të vijnë në debate? Jo, e kanë të ndaluar! Ai përballon vetëm debatet me njerëz të paguar. Deformimet këtu janë të shkallës maksimale.

Natyrisht, asaj i jep kohë sipas qejfit tënd, as 5 minuta nuk kanë kaluar. Unë e mbyll me kaq, duke denoncuar shkeljet e rënda dhe duke u bërë thirrje gazetarëve për një aleancë të re, një aleancë për të vërtetat e mëdha të çdo kombi të lirë. Të bëjmë gjithçka për transparencë të plotë dhe për t'i dhënë duart sa më shpejt këtij regjimi autokratik!